



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 1712 Prot 2

Gramsh më 22.05.2024

V E N D I M

Nr 34 datë.29. 04.2024

P Ë R

MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË GRAMSH NË ANKANDIN PUBLIK QË DO TË ZHVILLOHET NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE ME OBJEKT SHITJEN E 12 (DYMBËDHJETË) GARAZHDEVE ME SIPËRFAQE TOTALE 351.03 M² NË BANESËN ME 8 KATE DHE NJË KAT PARKIM NËN TOKË E NDËRTUAR ME FONDET E EKB-SË NË QYTETIN E GRAMSHIT

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjet e tij të datës 29/04/2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Gramsh në Ankandin Publik që do të zhvillohet nga Enti Kombëtar i Banesave me objekt shitjen e 12 (dymbëdhjetë) garazhdeve me sipërfaqe totale 351.03 m² në banesën me 8 kate dhe një kat parkim nën tokë e ndërtuar me fondet e EKB-së në qytetin e Gramshit”. mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Per qeverisjen vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1/a 1.1/b, neni 23, neni 54 piakat, e, g dhe k, Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar), Ligjin Nr.22/2018 “Për strehimin social” dhe VKM nr 898 datë 18.11.2020 “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të paprivatizuara”

V E N D O S I

1. Të miratohet pjesëmarrja e Bashkisë Gramsh në Ankandin Publik që do të zhvillohet nga Enti Kombëtar i Banesave me objekt shitjen e 12 (dymbëdhjetë) garazhdeve me sipërfaqe totale 351.03 m² në banesën me 8 kate dhe një kat parkim nën tokë e ndërtuar me fondet e EKB-së në qytetin e Gramshit

2. Të miratojë vlerën e bashkëfinancimit nga Bashkia Gramsh nëse do të shpallet fitues për këtë objekt 10 % të vlerës së shitjes në shumën 794,451 (shtatëqind e nëntëdhjet e katër mijë e katërqind e pesëdhjet e një), dhe kështu e kredisë për vitin 2024, në vlerën 437,476 (katërqind e tridhjet e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjet e gjashtë) kësti 6-mujor, vlerë e cila do të mbulohet nga zëri bashkëfinancime për investime parashikuar me VKB Nr 88 datë 27.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor të vitit 2024” Pasqyra Nr. 9 (pasqyra e investimeve)
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Enis ZANI



Di. Fisa. de Busetis
Sek. Keshillit
Zyrtar i Autenzuar
16



BASHKIA GRAMSH
NR RBGJ 1712/B
Mbërriti me Datë

16.05.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 575/ prot.

Elbasan, më 15.5.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.34 datë 29.04.2024 "Për miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Gramsh në ankandin publik që do të zhvillohet nga Enti Kombëtar i Banesave me objekt shitjen e 12 (dymbëdhjetë) garazhdeve me sipërfaqe totale 351.03 m², në banesën me 8 kate dhe një kat parkim nën tokë, e ndërtuar me fondet e EKB-së në qytetin e Gramshit", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI



Majlinda PERRIU